

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7860  
E shtunë, 10 gusht 2024  
Çmimi 0.50 €

Hamza, lideri i parë nga Ballkani që takon emisarin amerikan: U pajtuam për bashkëpunim FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## FRANCA: DËNOJMË VEPRIMET E NJËANSHME NË VERI, RREZIKOJNË PËRSHKALLËZIMIN E TENSIONEVE. FAQE 3



Ministria e Punëve të Jashtme e Francës ka reaguar në lidhje me zhvillimet e fundit në verium e Kosovës, konkretisht për mbylljen e Postës së Serbisë dhe për

paralajmërimet për hapjen e urës së Ibrit. Kjo ministri ka theksuar se dënon veprimet e njëanshme në veri, të cilat, sipas saj, rrezikojnë përshkallëzimin e tensioneve. "Këto

veprime rrezikojnë përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, parakusht për realizimin e perspektivës evropiane të dy vendeve", është thënë në reagimin e Francës

KFOR-I S'DËSHIRON TË SPEKULOJË PËR NJË LARGIM NGA URA E IBRIT F. 4



QEVERIA RIHAP THIRRJEN PËR SUBVENCIONE PËR GRATË E FAMILJEVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR F. 3



MURATI: QEVERIA PO I MBËSHTET BIZNESET NË VERI PËR HAPJEN DERI NË 2 000 VENDE TË REJA PUNE F. 8

RRITEN ÇMIMET E KONSUMIT NË KOSOVË F. 8

### SPORT

RIKTHEHET FUTBOLLI, SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJE F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Austria vendos të përfundojë furnizimin me gaz nga Rusia në vitin 2027

VJENË, 9 GUSHT - Koalicioni qeverisës i Austrisë ka rënë dakord ta përfundojë furnizimin me gaz rus në vitin 2027 dhe e ka përfshirë atë në strategjinë e re të sigurisë së vendit. Çështja aktualisht është në fazën e finalizimit, raporton "Moscow Times". Një nga arsyet pse Austria ka vendosur të heqë dorë

nga gazi rus është se paratë që Moskë merr nga shitja e karburantit përdoren për ta financuar konfliktin në Ukrainë. Qeveria austriake beson se varësia nga gazi rus kërcënon ekonominë austriake. Sipas vlerësimeve të fundit, gazi natyror nga Rusia përbën 80-90 për qind të

sisisë totale të gazit në tubacionet austriake. Ministria austriake e Energjisë, Leonore Gevesler, ka njoftuar në shkurt se synon ta shqyrtojë mundësinë e daljes nga kontratat afatgjatë midis kompanisë austriake të naftës dhe gazit OMV dhe Gazprom, të cilat janë të vlefshme deri në vitin 2040.



## Osmani i bashkohet deklaratës së Bidenit, el-Sisit dhe Al Thanit që bëjnë thirrje për armëpushim në Gaza

PRISHTINË, 9 GUSHT - "Është koha për të sjellë lehtësim të menjëhershëm si për popullin e shumëvujtur të Gazës, po ashtu edhe për pengjet e shumëvujtur dhe familjet e tyre. Ka ardhur koha për ta përfunduar marrëveshjen e armëpushimit dhe lirim të pengjeve dhe të arrestuarve", kanë deklaruar liderët e tri vendeve që ishin përfshirë në përpjekjet për të arritur një armëpushim në Gaza, ShBA-së, Egjiptit dhe Katarit. "Ne të tre dhe ekipet tona kemi punuar pa u lodhur gjatë shumë muajve për të krijuar një marrëveshje kuadër që tani është në tryezë dhe kanë mbetur vetëm detajet e zbatimit për t'u përfunduar. Kjo marrëveshje bazohet në parimet e përkrahura

nga presidenti Biden më 31 maj 2024 dhe miratuar nga Rezoluta 2735 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Nuk ka më kohë për të humbur dhe as justifikime nga asnjë palë për vonesa të mëtejshme. Është koha për t'i liru pengjet, për ta filluar armëpushimin dhe për ta zbatuar këtë marrëveshje", është thënë më tutje në këtë deklaratë të përbashkët.

Si ndërmjetës, presidenti amerikan Joe Biden, ai i Egjiptit Abdel Fattah el-Sisi dhe ai i Katarit, Sheikh Tamim bin Hamad Al Thani, kanë thënë se nëse është e nevojshme janë të përgatitur të paraqesin një propozim përfundimtar lidhës që zgjidh çështjet e mbetura të zbatimit në një mënyrë që përmbush



pritsmëritë e të gjitha palëve. "Ne u kemi bërë thirrje të dyja palëve të rifillojnë diskutimin urgjent të enjten, më 15 gusht, në Doha ose Kajro, për t'i mbyllur të gjitha boshllëqet e mbetura dhe për ta filluar zbatimin e marrëveshjes pa vonesa të mëtejshme".

Kësaj deklarate i është bashkuar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. "Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, i bashkohet deklaratës më poshtë nga presidenti amerikan Joe Biden, ai i Egjiptit Abdel Fattah el-Sisi dhe ai i Katarit, Sheikh Tamim bin Hamad Al Thani. Vuajtjet e njerëzve të pafajshëm duhet të ndalen!", është thënë në njoftimin e Presidencës në "X".

## ShBA-ja paralajmëron Iranin në rast sulmi ndaj Izraelit

UASHINGTON, 9 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë paralajmëruar Iranin se mund të pësojë një goditje shkatërruese nëse fillon një sulm në shkallë të gjerë kundër Izraelit. "Shtetet e Bashkuara i kanë dërguar një mesazh të qartë Iranit: rreziku i përshtatshëm serioz nëse ai do të nisë një sulm hakmarrës kundër Izraelit është jashtëzakonisht i lartë. Nëse ndiqet kjo rrugë, ka një rrezik serioz të pasojave për ekonominë iraniane dhe stabilitetin e qeverisë së saj të sapozgjedhur", është thënë në reagimin amerikan.



Ndërkohë Irani ka bërë me dije se ka në përdorim armë të reja të panjohura nga pala

kundërshtarë. Agjencia gjysmë-zyrtare lajmeve të Iranit, "Tasnim", ka raportuar se Marina

e Korpusit të Gardës Revolucionare ka raketa të reja "Kruize" të pajisura me koka luftarake të pazbulueshme por të cilat përmbajnë sasi të mëdha eksplozivi.

Sakaq Izraeli po përpiqet të arrijë një marrëveshje për lirim sa më shpejt të të gjithë pengjeve të cilët mbahen nga Hamasi. Ministri izraelit i Mbrojtjes, Yoav Gallant, ka kërkuar lirim të sa më shpejt të pengjeve.

Reagimi i Gallant vjen pas deklaratës së ShBA-së, Egjiptit dhe Katarit për Izraelin dhe Hamasin të cilët kanë kërkuar rifillimin e negociatave për një

armëpushim dhe marrëveshje për lirim të pengjeve. Izraeli ka bërë me dije se do të dërgojë negociatorë në bisedimet e propozuara, të cilat do të mbahen më 15 gusht në Doha ose Kajro. Hamasi nuk i është përgjigjur një kërkesë të tillë, por arritja e një marrëveshje mes palëve ka pak gjasa të ndodhë, kjo që ushtria izraelite me një vendim të fundit ka konfirmuar nisjen e një operacioni të ri tokësor në Rripin jugor të Gazës, në Khan Younis, pasi shteti hebraik zotëron informacione që tregojnë praninë e terroristëve dhe infrastrukturave terroriste në Gaza.

## Bullgaria bëhet me kryeministre në detyrë

SOFIJE, 9 GUSHT - Presidenti i Bullgarisë, Rumen Radev, ka zgjedhur Goritsa Grancharova-Kozhareva në pozitën e kryeministres në detyrë të vendit. Grancharova-Kozhareva, që deri më tani ka qenë kryetare e Dhomës së Auditimit, tani duhet ta emërojë kabinetin në detyrë të

Bullgarisë. Qeveria e re duhet të dërgojë emrat e kabinetit më së largu deri më 19 gusht. "Që nesër unë do të nis të bisedoj me ministrat aktualë dhe ekspertët e tjerë", ka thënë Grancharova-Kozhareva. Vendimi i Radevit, i bërë publik më 9 gusht, vjen pasi partitë politike dështuan në tri

përpjekje për të formuar një qeveri, pas mbajtjes së zgjedhjeve më 16 qershor. Radev ka thënë se zgjedhjet e reja të parakohshme parlamentare me gjasë do të organizohen më 20 tetor. Këto do të jenë zgjedhjet e shtata parlamentare në tre vjet në Bullgari.



KANDIDATI PËR KRYEMINISTËR I PDK-SË, BEDRI HAMZA, VAZHDON  
TAKIMET ME ZYRTARË TË LARTË AMERIKANË

## Hamza, lideri i parë nga Ballkani që takon emisarin amerikan: U pajtuam për bashkëpunim

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, është bërë lideri i parë nga Ballkani që ka takuar emisarin e ri të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kananof. Hamza ka bërë me dije se me emisarin amerikan është pajtuar për nevojën thelbësore për bashkëpunim dhe parashikueshmëri në marrëdhëniet në mes të dy shteteve. Ai ka thënë se mbështetja amerikane është përcaktuese për të ardhmen euroatlantike të Kosovës

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 9 GUSHT - Kandidati i për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka vazhduar takimet me zyrtarë të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA).

Në kuadër të vizitës zyrtare në Uashington, Hamza të premten është takuar me emisarin e ri të ShBA-së për Ballkanin, Alexander Kananof.

Hamza ka bërë me dije se me emisarin amerikan ka biseduar për zhvillimet e fundit në Kosovë.

"Pata takim të rëndësishëm dhe të ngrohtë në State Department, me udhëheqësin e ri të diplomacisë amerikane në Ballkan, z. Alexander Kananof. Jam tejet i nderuar që jam lideri i parë nga Ballkani që po e takoj z. Kananof, prej kur ka ardhur në detyrë e zëvendësndihmëssekretarit për Ballkanin Perëndimor. Eksperiencia unike e tij e bëri shumë të dobishëm diskutimin e sfidave në peizazhin e

ri gjeopolitik botëror. Në takim ishte edhe drejtoresha për Evropën Juglindore, znj. Colleen Hyland, e cila ka shërbyer në ambasadën amerikane në Kosovë dhe është një mbështetëse e madhe e jona", ka shkruar Hamza në "Facebook".

Më tutje, Hamza ka treguar se me Kananofin ka biseduar edhe për planin qeverisës si dhe për bashkëpunimin e ngushtë në mes të Kosovës dhe ShBA-së.

"Në këtë takim tepër të rëndësishëm dhe përmbajtësor, z. Kananof e urova edhe për postin e ri. Ne u pajtuam për nevojën thelbësore për bashkëpunim, koordinim dhe parashikueshmëri në marrëdhëniet tona me ShBA-në, ndërsa unë e prezantova planin e qeverisjes sime të fokusuar në zhvillim të hovshëm ekonomik, me investime strategjike, me rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe anëtarësimin në NATO, ku mbështetja e ShBA-së do të jetë përcaktuese", ka shkruar Hamza.

Ai ka thënë se do të angazhohet për rezultate konkrete në dobi të



qytetarëve, duke mos krijuar drama. "Kemi shumë punë për të bërë dhe kemi humbur shumë kohë, por jam më i bindur se kurrë se në Amerikë i kemi shtyllat kryesore të përkrahjes dhe mbrojtjes. Takimin e përfundova me optimizëm që konfuzioni politik i qeverisjes në Kosovë dhe gabimet e njëpasnjëshme medoemos do të revidohen, që të fokusohemi në rezultatet konkrete për qytetarët tanë dhe jo në krijim të dramave që nuk sjellin asgjë, pos izolim dhe injorim", ka shkruar Hamza.

Gjatë qëndrimit në ShBA, Hamza është takuar edhe me ambasadorin Daniel Fried. Duke vlerësuar lart kontributin e ambasadorit Fried, Hamza ka thënë se Kosova ka shumë miq në ShBA. "Sapo përfundova një takim

përmbajtësor në Këshillin Atlantik, një nga organizatat më të rëndësishme në Uashington, D.C. Pata nderin të bashkëbisedoj hollësisht me Ambasadorin Daniel Fried, i cili ishte Ndihmës Sekretar i Shtetit kur Kosova shpalli pavarësinë, si dhe me ekspertin e lartë për NATO-n, Rachel Rizzo. Ne biseduam për situatën aktuale në Kosovë dhe për hapat që duhet të ndërmarë Qeveria e ardhshme për ta kthyer vendin në rrugën e anëtarësimin të shpejtë në NATO. Aleatët dhe miqtë e Kosovës janë të shumtë në kryeqytetin e Amerikës dhe të botës së lirë. Plani im për qytetarët e Kosovës është i qartë dhe i fokusuar në rritjen ekonomike, rritjen e pagave dhe përmirësimin e mirëqenies. Këto objektiva të përbashkëta mund të arrihen vetëm në bashkëpunim me

miqtë e aleatët dhe jo nëse izolohehi nga bota", ka shkruar Hamza.

Po ashtu, Hamza është takuar edhe me James Carafano, i cili është i afërt me Partinë Republikane. "Pata nderin të takoj z. James Carafano, një nga udhëheqësit kryesorë për politikë të jashtme dhe siguri në këtë fondacion dhe Max Primorac, ekspert i lartë në Qendrën 'Margaret Thatcher'. Me z. Carafano, që është zë i respektuar republikan dhe personalitet i njohur publik, diskutuam për situatën në Kosovë dhe bashkëpunimin bilateral. Kosova ka qenë e bekuar me përkrahjen bipartizane, qoftë nga administrata e demokratëve, ashtu edhe ajo e republikanëve. Shteti ynë duhet ta ruajë këtë vlerë dhe të përmbahet nga animet eventuale në politikën dhe preferencat zgjedhore të qytetarëve amerikanë. Kosova ka miq dhe i duhen miq në tërë peizazhin politik amerikan, prandaj edhe takimet e mia kanë në fokus ndërtimin e lidhjeve të fuqishme, si me demokratët dhe administratën Biden, ashtu edhe me republikanët dhe zyrtarët e administratës së ish-presidentit Trump. Polarizimi në Kosovë nuk duhet të eksportohet. Na nevojitet puna e përbashkët. Ky ishte edhe premtimi im ndaj zyrtarëve në Heritage Foundation, Atlantic Council dhe ekspertëve të tjerë që takova këto ditë", ka shkruar Hamza.



## Qeveria rihap thirrjen për subvencione për gratë e familjeve të personave të zhdukur

PRISHTINË, 9 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka rihapur thirrjen për subvencione për vajza dhe gra që janë pjesë e familjes së ngushtë të personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Përmes një njoftimi për medie, qeveria ka bërë me dije se subvencionet vlejné vetëm për vajzat dhe gratë e familjes së ngushtë të personave që evidentohen në listat e

pensioneve për personat të zhdukur. Sipas njoftimit, afati i aplikimit zgjat deri më 29 gusht. "Qeveria e Republikës së Kosovës po shton mbështetjen për familjarët e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës. Me qëllim të rritjes së mirëqenies familjare dhe pavarësimin ekonomik të grave dhe vajzave, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, nëpërmjet Agjencisë

për Barazi Gjinore, në mbështetje me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, ka rihapur thirrjen për subvencione për gra dhe vajza që përbëjnë familje të ngushtë të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë, të evidentuar në listën e pensioneve për persona të zhdukur. Afati për aplikim është deri më 29 gusht 2024", ka njoftuar qeveria.









## Franca: Dënojmë veprimet e njëanshme në veri, rrezikojnë përshkallëzimin e tensioneve

Ministria e Punëve të Jashtme e Francës ka reaguar në lidhje me zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës, konkretisht për mbylljen e Postës së Serbisë dhe për paralajmërimet për hapjen e urës së Ibrit. Kjo ministri ka theksuar se dënon veprimet e njëanshme në veri, të cilat, sipas saj, rrezikojnë përshkallëzimin e tensioneve. “Këto veprime rrezikojnë përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, parakusht për realizimin e perspektivës evropiane të dy vendeve”, është thënë në reagimin e Francës

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministria e Punëve të Jashtme e Francës ka reaguar pas zhvillimeve të fundit në veriun e Kosovës. Pasi janë mbyllur disa njësi të Postës së Serbisë në veri të Kosovës dhe paralajmërimet për hapjen e Urës së Ibrit, komuniteti ndërkombëtar ka pasur reagime të shumta.

Parisi zyrtar ka theksuar se veprimet e njëanshme të Qeverisë së Kosovës rrezikojnë

normalizimin e raporteve. “Franca dënon ashpër përhapjen e veprimeve të njëanshme të autoriteteve të Kosovës në veri të vendit, të cilat ndikojnë në jetën e përditshme të komunitetit serb. Këto veprime rrezikojnë përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, parakusht për realizimin e perspektivës evropiane të dy vendeve”, është thënë në reagimin e Francës.

Sipas Ministrisë së Jashtme të Francës, në këtë formë rrezikohet edhe përshkallëzimi i tensioneve

të reja.

“Franca u bënë thirrje autoriteteve të Kosovës të përmbahen nga çdo veprim i mëtejshëm i njëanshëm, i cili do t’i përshkallëzonte më tej tensionet. Ajo i inkurajon të dyja palët të kthehen në tryezën e negociatave, me ndihmën e kujdesin e Bashkimit Evropian, në mënyrë që të bëjnë përparim në zbatimin e Marrëveshjes Bruksel - Ohër”, është thënë në reagim.

Për mbylljen e postës në veri si dhe për hapjen e Urës së Ibrit,

komuniteti ndërkombëtar ka dalë kundër.

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të premten e kaluar se vendet e Quint-it dhe NATO-ja nuk e mbështesin hapjen e urës së Ibrit në Mitrovicë në këtë kohë.

Ai këtë qëndrim e kishte dhënë pas një takimi të përfaqësuesve të vendeve të Quintit me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në Prishtinë. “Përfaqësuesit e Francës, Gjermanisë, Italisë, Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara, së bashku me ambasadorin e BE-së në Kosovë, u takuam sot me kryeministrin Kurti për ta njoftuar se qeveritë tona në konsultim me NATO-n nuk mund ta mbështesin asnjë ndryshim në statusin e tanishëm të urës së Mitrovicës në këtë kohë”, kishte thënë Hovenieri.

Me gjithë kundërshtimin e

vendeve të Quintit dhe NATO-s, Kurti ka thënë se “ura duhet të hapet”. Në këtë kontekst, autoritetet e Kosovës kanë filluar testimin e urës kryesore mbi lumin Ibër për të parë nëse është e sigurt për kalim të mjeteve motorike.

Reagime ka pasur edhe për aksionin ku janë mbyllur disa filiale të Postës së Serbisë në veri. Bashkimi Evropian i ka thirrje Qeverisë së Kosovës ta rishqyrtojë këtë vendim dhe të gjejë një zgjidhje të negociuar në kuadër të dialogut me Serbinë.

Reagim i menjëhershëm ka ardhur edhe nga Ambasada e Amerikës në Kosovë, zyrtarët e së cilës kanë folur kundër mbylljes së nëntë degëve të Postës së Serbisë në veri të Kosovës. Ambasada e ShBA-ja kishte theks se ky “veprim i njëanshëm dhe i pakoordinuar vë në rrezik qytetarët dhe ushtarët e KFOR-it”.

## AAC-ja për rastin e Osmanit: Shërbimet e Aeroportit të Shkupit vepruan në mënyrë profesionale

SHKUP, 9 GUSHT - Shërbimet në Aeroportin e Shkupit, përgjegjëse për kontrollet e sigurisë, kanë vepruar në mënyrë profesionale dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare, u tha në raportin e Agjencisë së Aviacionit Civil (AAC) të Maqedonisë së Veriut. Presidenca e Kosovës ka reaguar për këto gjetje, duke akuzuar Maqedoninë e Veriut për shkelje të praktikave dhe konventave ndërkombëtare. Kjo agjenci ka thënë se ka rishikuar të gjitha dëshmitë që lidheshin me incidentin e 1 gushtit ku është përfshirë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Sipas raportit, është konstatuar se shërbimet e aeroportit që janë përgjegjëse për kontrollet e sigurisë kanë vepruar në mënyrë profesionale dhe u janë përmbajtur rregullave që zbatohen ndërkombëtarisht, duke mos lejuar anashkalimin e standardeve dhe procedurave, qoftë edhe nën presionin e personave që shoqërojnë pasagjerët. "Refuzimi për t'i kryer kontrollet standarde të sigurisë me të njëjtët pasagjerë, sipas të dhënave, ka ndodhur edhe në vitin 2022 dhe 2023 kur kontrollet e sigurisë u pranuan vetëm pasi piloti i avionit kishte refuzuar të pranojë pasagjerë në avion pa u kryer një kontroll sigurie", është thënë në deklaratën e AAC-së. AAC-ja la theksuar se zyrtarët e

Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit nëse do të vepronin ndryshe nga rregullat e përcaktuara dhe do të lejonin lëshime dhe shmangie të procedurave të parapara, do të përballeshin me ndëshkime të ashpra nga agjencia, që është trup përgjegjës për rregullimin e tyre. Kjo agjenci ka thënë se si trup i pavarur dëshiron të qëndrojë larg përplasjeve politike lidhur me këtë ngjarje dhe shprehu keqardhje që në vend të zgjidhjes profesionale të këtij incidenti, do të nxirren mësim dhe do të ndërmerren masa adekuate për shmangien e tyre në të ardhmen. "Ne jemi dëshmitarë të përpjekjeve për përfitime të poenëve politikë dhe për ta shtrembëruar arsyen e vërtetë të kësaj ngjarjeje", është thënë në deklaratë. Presidenca e Kosovës ka thënë se Osmanit ishte tentuar t'i merrej telefoni personal nga një pjesëtar i sigurimit të Aeroportit të Shkupit, në kundërshtim të, siç ka thënë, praktikave ndërkombëtare dhe Konventës së Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike. Ky institucion i ka cilësuar "provokim" ngjarjet e ndodhura në Aeroportin e Shkupit, përderisa autoritetet maqedonase kanë shprehur keqardhje për ngjarjen dhe kanë nisur hetimin për të. Pas publikimit të gjetjeve të Agjencisë së Aviacionit Civil maqedonase, ka reaguar Presidenca e Kosovës. Sipas këtij institucioni, në asnjë vend të botës kreut të shtetit



nuk i kërkohet t'i kontrollohet bagazhi personal, as çanta personale, "e lëre më telefoni personal". Ky institucion ka theksuar se nga dhjetëra vende të botës që ka vizituar presidentja Osmani, vetëm aeroportet në Maqedoninë e Veriut refuzojnë të aplikojnë praktikën dhe konventat ndërkombëtare sa i përket kreut të një shteti. "Republika e Maqedonisë së Veriut ka shkelur rregullat ndërkombëtare që aplikohen çdo kund në botë duke kërkuar skanimin e telefonit të presidentes së një shteti tjetër, gjë që do të paraqiste potencial për cenim të sigurisë kombëtare", është thënë në reagim.

Presidenca ka thënë se Osmani nuk është kthyer nga vizita e saj jashtë vendit përmes Aeroportit të Shkupit pasi ekipi i saj i sigurisë "ka vlerësuar se pas propagandës marramendëse nuk ekzistojnë as kushtet bazike të sigurisë për një gjë të tillë". Po ashtu, më herët Presidenca e Kosovës ka deklaruar menjëherë se e kishte njoftuar për incidentin kryeparlamentarin e Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi. Më 1 gusht Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut ka thënë se në aeroport kishte shkuar një pjesëtar i sigurimit të Gashit, që ishte polic, "me dy persona të tjerë (policë) dhe filluan t'i kërcënojnë punëtorët e Aeroportit dhe të pyesin se kush i ka

shkaktuar problem presidentes". Gashi më pas ka deklaruar se ndërhyrja e tij kishte për qëllim vetëm parandalimin e një incidenti diplomatik. Përderisa nga zyra e Osmanit e kanë cilësuar si provokim këtë ngjarje dhe kanë thënë se ka pasur shkelje të praktikave ndërkombëtare, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë një vizite në Shkup më 5 gusht tha se po pret raportin zyrtar që do të përpilohet pasi autoritetet t'i kryejnë hetimet e nevojshme për këtë ngjarje. Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë raporte diplomatike dhe deri më tani nuk kanë pasur incident të kësaj natyre.

## Zëdhënësi i qeverisë: Shtimi i masave ndaj Kosovës e shton padrejtësinë, pse s'ka sanksione ndaj Serbisë?



PRISHTINË, 9 GUSHT - Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, i është përgjigjur paralajmërimit të Bashkimit Evropian (BE) rreth mundësisë së shtimit të masave ndaj Kosovës. Ai ka thënë se koha ka dëshmuar që masat e BE-së ndaj Kosovës kanë qenë të padrejta. "Masat nuk janë zgjidhje. Koha ka dëshmuar që masat e BE-së ndaj Kosovës kanë qenë të padrejta. Ato vazhdojnë të jenë të tilla për aq kohë sa janë në fuqi. Shtimi i tyre vetëm sa do ta thellonte padrejtësinë. Në anën tjetër, shtrohet pyetja çfarë masa ndërmori BE-ja ndaj Serbisë e cila

pas sulmit terrorist dhe paramilitar shpalli Ditë Kombëtare Zie për terroristët e vrarë në Banjskë, kreun e të cilëve, Millan Radoičiq, e strehon dhe financon?", ka thënë Kryeziu për "RTV21". Duke folur për mbylljen e nëntë zyrave të Postës së Serbisë në Veri të Mitrovicës si dhe hapjen e Urës së Ibrit, Kryeziu tha se Kosova ka nevojë për mbështetjen e BE-së dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sidomos në fushën e sundimit të ligjit dhe të respektimit të marrëveshjeve të arritura në Bruksel. "Ne kemi nevojë për mbështetjen e BE-së

dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sidomos në fushën e sundimit të ligjit dhe të respektimit të marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Mbyllja e nëntë zyrave të Postës së Serbisë të cilat kanë operuar pa licencë dhe në mënyrë ilegale është çështje e sundimit të ligjit. Ndërkaq hapja e urës së Mitrovicës mbi lumin Ibër është çështje e lirisë së plotë të lëvizjes, sundimit të ligjit dhe respektimit të marrëveshjeve të dala nga Brukseli që në vitin 2015, përveçse kontributi i drejtpërdrejtë i integritetit të mëtejshëm të qytetarëve tanë", ka thënë Kryeziu.

## Haziri: Për tri vjet e gjysmë Kurti i ka bërë nëntë veprime të pakoordinuara me ndërkombëtarët

PRISHTINË, 9 GUSHT - Nënkrjetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për moskoordinim me aleatët e Kosovës. Ai ka bërë me dije se gjatë këtij mandati shefi i qeverisë, Albin Kurti, i ka bërë nëntë veprime të cilat nuk kanë qenë të

koordinuara me ndërkombëtarët. Haziri ka thënë për "Express" se Kurti ka shkaktuar vetëm kriza dhe sërish është rikthyer te kërkesat e BE-së. "Për tri vjet e gjysmë z. Kurti i ka bërë nëntë veprime të pakoordinuara me faktorin ndërkombëtar. Të gjitha këto veprime kanë një historik të shkurtër, blic histori,

e cila, përkundër qëllimit për të shtyrë para, prapë ka rënë në nivelin e kërkesës së BE-së. Përkundër që kemi masa ndëshkuese ndaj Kosovës, të cilat nuk po mund të largohen pasi Kosova nuk ka asnjë lloj raporti mirëbesimi me partnerët, shtetet në rajon e institucionet e mëdha siç është NATO e BE", ka thënë Haziri.



## Prokuroria Speciale ngre aktakuzë kundër 10 personave

PRISHTINË, 9 GUSHT - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër dhjetë (10) personave. Nëntë prej tyre A.

N., M. B., Sh. K., E. D., R. D., F. M., B. G, R. M. dhe M. B janë akuzuar për shkak të veprës penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294, par. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-

së. Ndërsa kundër një të akuzuari është paraqitur aktakuzë në drejtim të veprës penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 366, par. 1 i KPRK-së.



## Bejta: Gjykatat mos t'i hedhin poshtë kërkesat për kompensimin e dëmeve të luftës nga Serbia



PRISHTINË, 9 GUSHT - Shoqata për Dëmet e Luftës "Ngritja e Zërit" ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese një mori vendimesh të Gjykatës Supreme drejtuar Qeverisë së Serbisë për kompensimin e dëmeve të luftës.

Jahir Bejta, kryetar i kësaj shoqate, ka thënë se kërkesa e tyre është që gjykatat e Kosovës mos t'i hedhin poshtë kërkesat e tyre për kompensim për dëmet e luftës nga Qeveria e Serbisë. Për këtë, ai ka thënë se i kanë dorëzuar këto vendime në

Kushtetuese.

Ai ka theksuar se përpos në gjykatat vendore, do të kërkojnë drejtësi për krimet serbe edhe në gjykata ndërkombëtare. "Të gjitha herët kur ka qenë interesi publik ne kemi qenë bashkë për ta mbrojtur drejtësinë e viktimave të luftës. Nga Gjykata Kushtetuese e kemi kaluar në Gjykatën Themelore dhe, së fundmi, kemi bërë kërkesë në Gjykatën Supreme. Tani jemi këtu për vendimet e Gjykatës Supreme në përputhje me Kushtetutën.

Gjykatat tona janë të obliguara t'i implementojnë konventat ndërkombëtare të cilat i mbrojnë të drejtat themelore të njeriut, por gjyqësori ynë po i hedh poshtë. Nuk ka diçka më të rëndësishme se jeta e njeriut dhe dinjiteti njerëzor. Gjykatat tona përpos që i refuzojnë, i rrezojnë palët, që të drejtat e tyre të mohuara t'i kërkojnë nëpër gjykatat e Beogradit. Kjo është e papranueshme, kjo është më shumë se fyerje, më shumë se vrasje, humbje e dinjitetit", ka thënë Bejta.

## Në Graçanicë protestohet kundër femicidit dhe dhunës ndaj grave

GRAÇANICË, 9 GUSHT - Para Stacionit të Policisë në Graçanicë është organizuar një protestë kundër dhunës në familje. Pjesëmarrësit kanë thënë se dhuna nuk është çështje private dhe se shoqëria dhe institucionet duhet të bëjnë më shumë në këtë çështje.

Organizatorja e protestës, aktivistja dhe përfaqësuesja e organizatës joqeveritare "Pravo na pravo", Millica Stojanović-Kostiç, deklaroi se femicidi duhet të dënohet me burgim të përjetshëm.

"Më në fund duhet të zgjohemi dhe të kuptojmë se dhuna nuk mund të jetë dhe nuk është çështje private. Kur shohim apo dëgjojmë se dikush po ushtron dhunë ndaj dikujt, duhet ta denoncojmë menjëherë në polici", ka thënë ajo.

Kjo protestë është mbajtur pasi më 2 gusht vdiq M. Zh., nga komuna e Graçanicës, pas lëndimeve të rënda trupore që dyshohet se ia shkaktoi bashkëshorti.

I dyshuari në atë rast, D. Zh. është arrestuar për dhunë në familje, por pas vdekjes së bashkëshortes, prokuroria e ka riklasifikuar çështjen në vrasje të rëndë dhe ai



tani ndodhet në paraburgim. Millica Stojanović-Kostiç ka nënvizuar se M. Zh., ka vdekur në shtëpinë e saj, në vendin ku do të duhej të ishte e sigurt dhe vdiq nga duart e bashkëshortit, i cili, sipas saj, duhet të ishte mbrojtësi i saj më i madh.

Pas protestës, organizatorët kanë dorëzuar në komunën e Graçanicës dhe Policinë e Kosovës kërkesat lidhur me parandalimin e dhunës ndaj grave.

Disa nga kërkesat e protestuesve

janë që policia të merret më seriozisht me denoncimet që gratë bëjnë për dhunën në familje, që viktimat të trajtohen me respekt dhe jo të pyeten "a e provokove" dhe "pse të kanë rrahur". Nga autoritetet lokale është kërkuar t'i monitorojë raportet për dhunën ndaj grave në mënyrë më të hollësishme dhe që Zyra për Barazi Gjinore të ofrojë mbështetje më të madhe për viktimat, ndihmë juridike dhe psikologjike falas.

Snezhana Jovanović nga

komisioni për siguri në komunën e Graçanicës ka thënë se policia në këtë komunë ka dështuar në rastin e vrasjes së gruas dhe se ngjarje të tilla nuk duhet të përsëriten. Ajo ka theksuar se gratë normalisht nuk gjejnë mbështetje institucionale kur bëhet fjalë për dhunën ndaj tyre.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në reagimet e tyre pas vdekjes së gruas nga Graçanica, kanë thënë

se rastet e vrasjeve të grave nuk duhet të tolerohen, duke u bërë thirrje institucioneve të drejtësisë që t'i dënojnë autorët në mënyrë që të mos përsëriten rastet e femicidit.

Në prill të këtij viti brenda disa ditësh dy gra janë vrarë nga bashkëshortët e tyre në Kosovë. Po ashtu, disa ditë pas vdekjes së gruas nga Graçanica, një grua është plagosur me armë zjarri në Fushë-Kosovë. Bashkëshorti i saj dyshohet për kryerjen e veprës penale "vrasje e rëndë në tentativë", "armëmbajtje pa leje" dhe "mospërfillje të gjykatës".

Ndërsa Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist ka zhvilluar një aksion simbolik më 7 gusht pranë Stacionit të Policisë në Prishtinë dhe më pas pranë Prokurorisë së Shtetit, në ndërtesat e të cilëve ka shkruar "Po i vrisni gratë".

Nga kjo organizatë kërkuar veprime urgjente nga institucionet dhe shoqëria për luftimin e dhunës ndaj grave. Nga viti 2010 deri në gusht të vitit 2024, në Kosovë janë vrarë 58 gra. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

## Ministrja Haxhiu viziton Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë

MITROVICË, 9 GUSHT - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka vizituar të premtën Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Ajo ka bërë me dije se nga

drejtori i kësaj qendre, Benasim Medic, është njoftuar për punën dhe angazhimin e stafit. "Nga drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë,

Benasim Medic, u njoftova për punën dhe angazhimin e stafit, mbarëvajtjen e rendit shtëpiak si dhe format e angazhimit të personave të dënuar. Qendra e

Paraburgimit në Mitrovicë është shembull i mirë i bashkëpunimit ndërmjet të gjitha komuniteteve si dhe shembull i mosdiskriminimit", ka njoftuar Haxhiu.





# Instituti i Mjekësisë Ligjore në Kosovë: Personi i vrarë në Serbi është Faton Hajrizi

PRISHTINË, 9 GUSHT - Instituti i Mjekësisë Ligjore ka konfirmuar se trupi i pajetë që ka ardhur të premten nga Serbia i personit të vrarë në Lloznicë është i Faton Hajrizit.

Drejtori i Departamentit të Laboratorëve Mjeko-Ligjorë në Institutin e Mjekësisë Ligjore, Agron Thaqi, ka thënë se trupi i Faton Hajrizit tanimë është identifikuar edhe nga familjarët e tij. "Mbrëmë rreth orës 1 është pranuar trupi i pajetë i cili është i Faton Hajrizit. Këtë po e deklarojmë pas urdhrat që është bërë nga Prokuroria, respektivisht nga prokurori përgjegjës. Është identifikuar nga

familjarët e rastit në pranimin e mjekut kujdestar", ka thënë Thaqi.

Edhe avokati Arianit Koci e ka konfirmuar se nëna e Faton Hajrizit ka konstatuar se trupi është i djalit të saj. "Spekulimet dhe interpretimet amatore plot smirë dhe xhelozitë kanë penguar në kryerjen e misionit tim - kthimin e trupit të pajetë të Faton Hajrizit! Prej sot spekulimet duhet të ndalen! Familja Hajrizi po lëndohet dhe dëmtohet shumë. Kufomën të cilën e solla mbrëmë është pa asnjë dyshim e Fatonit. Këtë e pohoi sot nëna e Fatonit gjatë procedurës së identifikimit", ka njoftuar Koci.



## Albin Kurtit i mungojnë lidhshipti dhe sinqeriteti për ta hapur Urën e Ibrit



Shkruan: Besa ISMAILI

Se sa të përnjëmendta i ka kryeministri Kurti dhe qeveria e tij deklaratat "Ura e Ibrit është çështje e brendshme e Kosovës", ka treguar Banjska. Për Banjskën, kryeministri Kurti ka mësuar në atë moment kur kanë kuptuar gjithë qytetarët e Republikës së

Kosovës. Pra, as edhe një minutë më përpara. Madje, derisa ai dhe oborrtarët e tij po kthjelloheshin nga gjumi atë mëngjes, përfaqësuesit e shteteve të QUINT-it, veç më dhe njëzëri kishin dal me deklarata dënuese.

Se këndejmi, për ta shkurtuar tregimin, edhe kryeministri Kurti i ka të qarta këto gjëra, por po bën lojën e tij të zakonshme llafe-llafe, jo vetëm që u parandalua banjskëzimi i Kosovës, por u këput në rrënjë "wagnerizimi" i veriut. Kaq. Tani për tani.

Por, më lejoni t'ju rikujtoj disa nga një sërë arsyesh pse lidhja ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së

është jetike për Kosovën:

1. Partneriteti strategjik: Kosova ka zhvilluar një partneritet të ngushtë strategjik me ShBA-në, i cili ka qenë vendimtar në mbështetjen e sovranitetit, sigurisë dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës.

2. Zhvillimi ekonomik: ShBA-të janë një nga partnerët dhe investitorët kryesorë tregtarë të Kosovës, duke ofruar mbështetje jetike për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të Kosovës.

3. Bashkëpunimi për sigurinë: ShBA-të kanë luajtur rol kyç në mbështetjen e sektorit të sigurisë së Kosovës, duke përfshirë

ndihmën ushtarake dhe ato të zbatimit të ligjit. Ky bashkëpunim është thelbësor për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

4. Mbështetja politike: ShBA-ja ka qenë një mbështetëse e fuqishme e pavarësisë së Kosovës dhe secilës përpjekje shtetndërtuese, duke ofruar mbështetje thelbësore politike në skenën ndërkombëtare.

5. Vlerat e përbashkëta: Kosova dhe ShBA-ja ndajnë vlera të përbashkëta si demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Këto vlera të përbashkëta përbëjnë bazën për një lidhje të fortë midis dy vendeve.

Në përgjithësi, lidhja ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së është thelbësore për zhvillimin dhe stabilitetin e vazhdueshëm të Kosovës, si dhe për promovimin e interesave dhe vlerave të përbashkëta në rajon dhe më gjerë.

Kosova nuk ka asgjë që i duhet për të shtrirë ushtruar sovranitet të plotë, për t'u integruar dhe zhvilluar, e që s'mund t'a bëjë këtë në partneritet me aleatë. E lëre më hapjen e urës. Vetëm do lidhshipti dhe sinqeriteti kjo gjë.

Albin Kurti nuk i ka asnjëherë, as lidhshiptin dhe as sinqeritetin. Fatkeqësisht, për ne dhe Kosovën!

## KFOR-i s'dëshiron të spekulojë për një largim nga ura e Ibrit

PRISHTINË, 9 GUSHT - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka bërë me dije se "nuk duam të spekulojmë për ndonjë skenar në të ardhmen" nëse institucionet e Kosovës i kërkojnë të largohet nga ura mbi lumin Ibër.

Qeveria e Kosovës ka thënë se synon ta hapë për qarkullim të automjeteve urën mbi Ibër, që ndan Mitrovicën e Jugut me shumicë shqiptare, dhe atë të Veriut me shumicë serbe.

Ushtarët italianë në kuadër të misionit të KFOR-it ndodhen në urën mbi lumin Ibër, ndërsa afër ndodhen edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës. "KFOR-i vazhdon ta zbatojë mandatin e tij, që derivon nga Kombet e Bashkuara, për të kontribuar për mjedis të sigurt dhe liri të lëvizjes për të gjithë njerëzit nga komunitetet që jetojnë në Kosovë,



në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme, përfshirë edhe përmes pranisë fikse në urën e Mitrovicës dhe patrullimet e rregullta në zonën përreth", ka thënë një zëdhënës i KFOR-it për "Radion Evropa e Lirë".

KFOR-i ka përsëritur qëndrimin se nuk do të ngurrojë të ndërmarrë "çdo veprim të nevojshëm" për t'iu përgjigjur çdo zhvillimi që mund të ndikojë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Qeveria e kryeministrit të Kosovës,

Albin Kurti, në mes të korrikut ka njoftuar se synon ta hapë urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë. Por, ditët e fundit autoritetet në Kosovë janë duke bërë inspektime për hapjen e urës. Një inspektim teknik për

fuqinë mbajtëse të urës ishte paraparë edhe me marrëveshjen e arritur Kosovë - Serbi si hap që duhet kryer para hapjes së saj për qarkullimin e automjeteve.

Vendet e Quintit, ShBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia, më 2 gusht deklaruan se nuk e mbështesin hapjen e urës në këtë moment.

KFOR-i më herët ka thënë se çdo vendim për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër duhet të merret në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ura, aktualisht, është e hapur vetëm për këmbësorë, edhe pse në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është rënë dakord që të hapet edhe për qarkullimin e automjeteve. Përveç faktorit ndërkombëtar, edhe serbët lokalë dhe zyrtarët në Serbi janë deklaruar kundër hapjes së urës kryesore mbi Ibër.

## Rriten çmimet e konsumit në Kosovë

PRISHTINË, 9 GUSHT - Indeksi i Tërësishëm i Harmonizuar i Çmimeve (IHÇK) të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2.2-përqindësh në korrik të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Inflacioni mujor ishte 0.3 për qind në korrik 2024, ka njoftuar të premtën Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK). Sipas ASK-së, kjo është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: bileta të fluturimeve (22.0 për qind); kafe, çaj dhe kakao (7.7 për

qind); peshq (7.7 për qind); pije alkoolike (7.2 për qind); pemë (6.3 për qind); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (6 për qind); qelqurina, takëme dhe mjete të kuzhinës (5.9 për qind); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5.6 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (5.6për qind); veshje (4.9 për qind); kujdes personal (4.3 për qind); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (3.7 për qind); gjëra dhe pajisje të tjera

rekreative, kopshte dhe manare (3.6 për qind); bukë dhe drithëra (3.1 për qind); duhan (2.7 për qind); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (2.1 për qind); prodhime ushqimore (2.1 për qind); shërbime hoteliere (1.9 për qind); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (1.8 për qind); pajisje shtëpiake (1.5 për qind); mish (1.4 për qind); energji elektrike (0.9 për qind) dhe qumësht, djathë dhe vezë (0.3 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 24-

përqindësh në IHÇK. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: perime (-5.2 për qind) me një ndikim prej -0.2-përqindësh në IHÇK. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0.3-përqindësh në korrik 2024, krahasuar me qershorin 2024, për shkak të ngritjes së çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: bileta të fluturimeve (8,7 për qind); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit



personal (2.9 për qind); energji elektrike (2.3 për qind); pemë (1.8për qind); mish (0.7 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.5-përqindësh në IHÇK. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: perime (-5.7 për qind) me një ndikim prej -0.2-përqindësh në IHÇK.

## Pse disa kompani serbe janë regjistruar sipas ligjeve të Kosovës e disa jo?

PRISHTINË, 9 PRILL - Në Kosovë ekzistojnë dy ndërmarrje publike serbe të cilat veprojnë sipas ligjeve të vendit, "MTS d.o.o." dhe "Elektrosever".

"MTS d.o.o." ka licencë për të ofruar shërbime në fushën e telekomunikacionit, ndërsa "Elektrosever" për furnizimin me energji elektrike të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës si dhe për faturimin e rrymës atje. Të dyja këto kompani serbe në Kosovë operojnë me euro dhe në këtë valutë i lëshojnë edhe faturat për pjesëtarët e komunitetit serb. E përbashkëta e tyre është që detajet për to janë negociuar në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Pse nuk ka ndodhur e njëjta gjë me Postën e Serbisë në Kosovë?

Më 5 gusht, autoritetet e Kosovës i mbyllën në veri të vendit nëntë degë të Postës së Serbisë, me arsyetimin se kjo ndërmarrje nuk është e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Ish-kryesuesja e delegacionit të Kosovës në kohën e negociatave për "Elektrosever"-in dhe MTS-në, Edita Tahiri, nuk ka dashur ta komentojë për çështjen e Postës, duke thënë se nuk i përket fushës së saj.

Serbia dhe Bashkimi Evropian insistojnë që për shërbimet postare duhet të diskutohet në Bruksel ashtu siç janë marrë vesh palët në të kaluarën.

Sociologu dhe analisti politik në Prishtinë, Artan Muhaxhiri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se dialogu në Bruksel është



përshkruar me mungesë të madhe të transparencës, dhe se askush nuk i di me saktësi arsyet e vërteta të moszgjidhjes së kësaj problematike. "Përvojat e deritashme rrëfejnë që vetëm zgjidhjet e pranuar mes tri palëve kanë stabilitet afatgjatë. Tentimet për imponime mund të tingëllojnë triumfalistë, mirëpo kostot përfundimtare i zhbëjnë pretendimet fillestare", ka thënë ai.

Ekonomisti dhe kryeredaktori i platformës Strateo në Beograd, Sasha Gjogoviq, beson se dialogu është çelësi. "Nuk është e mundshme të gjenden zgjidhje të njëanshme. Është e rëndësishme të ketë komunikim interaktiv mes palëve dhe BE-së. Por, e shoh që (i dërguari evropian për dialog, Miroslav Lajçak është shumë pasiv në këtë periudhë vakumi mes zgjedhjeve

në BE dhe atyre në ardhje në Shtetet e Bashkuara", ka thënë Gjogoviq.

Prandaj, ai ka pohuar se duket sikur ekziston një "marrëveshje e pashkruar" Prishtinë - Beograd, që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ta çojë përpara agjendën e tij në këtë kohë vakumi dhe, sipas Gjogoviqit, në fund Serbia dhe serbët e Kosovës do të detyrohen ta pranojnë realitetin e ri.

### Rëndësia e Postës për serbët në Kosovë

Nëpër degët e Postës së Serbisë, e cila ofron edhe shërbime financiare jobankare, qytetarët serbë në veri të Kosovës mund të kryenin pagesa të ndryshme për institucionet që punojnë sipas sistemit paralel serb, të pranin

ose të dërgonin letra, si dhe të merrnin pagesa prej buxhetit të Serbisë, sikurse pensionet, apo ndihmat për fëmijë, në dinarë serbë.

Degët e kësaj poste në pjesën jugore vazhdojnë punën. Megjithatë, sigurimi i ndihmave përmes postës është vështirësuar këtë vit, pas fuqizimit të rregullores së re të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për ta bërë euron valutë të vetme për kryerje të pagesave me para të gatshme. Si rrjedhojë, u ndalua qarkullimi i dinarit serb. Kosova dhe Serbia kanë zhvilluar disa raunde negociatash në Bruksel për të gjetur një zgjidhje për dinarin. Nëpër ato bisedime u tha se pala serbe ka shtyrë përpara mundësinë e licencimit në Kosovë të bankës Kursimorja e Postës, por se pala e Kosovës nuk është pajtuar, me

arsyetimin se Banka Qendrore e Kosovës, si institucion i pavarur, vendos për licencim.

Me mosfunksionimin e Kursimores së Postës dhe të Postës së Serbisë, analistët në Serbi besojnë se jeta e serbëve lokalë në Kosovë është vështirësuar, por që asnjëra palë nuk është e interesuar për mirëqenien e tyre.

Gjogoviqi e ka përmendur si mundësi shkuarjen e serbëve në Serbi për t'i kryer punët e tyre, por ka thënë se ajo alternativë mund të bëhet e kushtueshme dhe të mos jetë praktikë për ta.

Ndërkaq Popovi beson që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, për të cilin palët kanë arritur dy marrëveshje që nuk janë zbatuar kurrë, do të mund t'i mbulonte gjithë këto aspekte.

Në një draft-statut të Perëndimit, që iu prezantua palëve vitin e kaluar, si bazë për formim të Asociacionit është paraparë që ky trup ta ketë buxhetin e vet në një llogari në ndonjërin nga bankat e licencuara nga BQK-ja.

Muhaxhiri ka vlerësuar se "përfshirja e të gjitha kompanive serbe që funksionojnë në Kosovë, nën ombrellën institucionale shtetërore, është e pashmangshme", por thotë se të dyja palët tani janë duke synuar përfitime maksimale prej procesit të dialogut.

Disa serbë në veri, me të cilët ka biseduar "Radio Evropa e Lirë", kanë thënë se janë të dëshpëruar për mbylljen e degëve të Postës së Serbisë, dhe se veprime të tilla "nuk çojnë drejt paqes".

## Murati: Qeveria po i mbështet bizneset në veri për hapjen e deri në 2 mijë vende të reja pune

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka paralajmëruar një iniciativë të re të qeverisë që synon krijimin e deri në dy mijë vende të reja pune në veri të vendit. Murati ka bërë me dije se kjo do të mbështetet

përmes subvencionimit të pagave për punëtorët si për bizneset e reja ashtu edhe ato ekzistuese në katër komunat në veri. "Me rivendosjen e rendit dhe ligjit në katër komunat veriore të vendit, tani po shohim dita ditës edhe

hapjen e bizneseve të reja dhe shtimin e aktivitetit afarist në atë pjesë. Qeveria po mbështet të gjitha bizneset e reja dhe ato ekzistuese në katër komunat në veri për hapjen e deri në dymijë vende të reja pune, përmes

subvencionimit të pagës për punëtorët. Për më shumë informata, mjafton të drejtoheni tek zyrat e Agjencisë së Punësimit që tashmë gjenden edhe në hapësirat e objekteve komunale", ka shkruar Murati në "Facebook".



# Të gjithë njerëzit (sekretë) të Watergate

Pranë – duke e siguruar se “historia do të ishte më bujare” se bashkëkohësit e tij – i qëndroi vetëm Henry Kissinger që ishte Sekretari i tij i Shtetit. Gazetat e goditën me të gjithë plumbin që mbanin në shtypshkronjë. Miqtë e tij – edhe ata më të besuarit – ia kthyen shpinën për të mos kompromentuar edhe karrierën e tyre personale. Dhe njerëzit në rrugë – pa hezitim – thoshin se, nga një tip si ai, nuk do të kishin blerë as një makinë të përdorur.

I tronditur nga rezultatet e hetimit të Watergate, Richard Nixon dha dorëheqjen si president i Shteteve të Bashkuara më 9 gusht 1974. Një zgjedhje e detyruar për të shmangur rrezikun e impeachment-it që do ta dërgonte atë, nën aktakuzë, para gjykatësve të Gjykatës Supreme. Watergate ishte – dhe është – një hotel me pesë yje në Uashington, i cili i shton luksit të origjinës së tij, sharmin e një historie me spiunë, që e ktheu përmbys sistemin politik amerikan. Dhe për të kuptuar jehonën e saj me kalimin e kohës, mjafton të kujtojmë se sot për të fjetur në dhomën 214, ku nisi skandali, kushton një mijë dollarë, por kërkon një rezervim shumë më herët.

Rreth hotelit ka gjashtë ndërtesa – midis lumit Potomac dhe Virginia Avenue – të cilat mbajnë qindra zyra. Në fillim të viteve '70, kati i gjashtë ishte në dispozicion të shtabit drejtues të Partisë Demokratike, që merrej me zgjedhjet presidenciale. Richard Nixon – republikan, në detyrë – po prezantohej për mandatin e tij të dytë dhe po marshonte drejt Shtëpisë së Bardhë, ndërsa sfiduesi i tij George McGovern dukej se po ecte nëpër shtigje që, javë pas javë, po bëheshin më të rrëshqitshme. Dhe doli që një grup ish-007-sh po punonin për të shtuar halle të tjera, për ata që tashmë nuk dinin si t'u iknin atyre që kishin.

U zbulua rastësisht më 17 qershor 1972. “Për faj” të një cope shiriti ngjites me përmasa vetëm 380 milimetra katrorë (dy gishta) e vendosur në gjuhëzën e një brave, për të siguruar që dera të mbetej e hapur. Frank Wills – përgjegjës për mbikëqyrjen e natës – e vuri re, por sigurisht nuk dyshoi për ndonjë skenar me agjentë sekretë. Ai besonte – e deklaroi këtë në gazeta të nesërmen – se e kishin harruar pastrueset. Wills hoqi ngjitesin dhe aktivizoi mbylljen automatike. Por kur në patrullimin e dytë gjeti derën të mbështetur në një copë tjetër shiriti, thirri policinë e cila arrestoi pesë persona. Mjetet e



vjedhjes që kishin në dispozicion dukeshin paksa të sofistikuara për kriminelët “normalë”. Dhe, për të përjashtuar çdo lidhje me botën e kriminit, mjaftuan dy armët e mbushura me gaz lotsjellës që asnjë kriminel nuk do t'i kishte përdorur, si dhe dy kamera me dyzet rrotulla filmi.

Të nesërmen, çështja mund të kishte përfunduar me dënime për Bernard Barker, Virgilio González, Eugenio Martínez, James McCord dhe Frank Sturgis. Por, në sallën e gjyqit për të marrë pjesë në seancë – për një arsye tjetër – ishte gazetari i gazetës Washington Post, Bob Woodward, i cili u gjend në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, por pati zgjuarsinë për t'i kushtuar vëmendje faktit që një nga të akuzuarit, ishte i punësuar nga CIA. Artikulli, i botuar në faqen e parë, ishte i pari ndër 79 raportime, të cilat, të paktën në fillim, kishin pak interes për opinionin publik, por që, goditje pas goditjeje, u bënë topa që shpërthyen kundër Shtëpisë së Bardhë dhe Presidentit Nixon. Hetimi arriti të përvijojë konturet e një komploti, për të njohur paraprakisht lëvizjet e kundërshtarëve, me qëllim bojkotimin e tyre.

Strategjia ishte planifikuar disa vjet përpara 1972-shit dhe, deri në atë pikë, ishte realizuar në mënyrë djallëzore. Projekti iu besua Gordon Liddy-t, i cili ishte një person kyç në stafin e rizgjedhjes së Nixonit. Megjithatë, për zbatimin praktik të tij, ishte i nevojshëm miratimi i John Newton Mitchell, i cili në ekipin zgjedhor mbante rolin e drejtorit. Emisarët republikanë – me manipulime dhe mashtrime –

arritën të eliminonin kandidatët demokratë më të zotë për t'i bërë ballë Niksonit, duke i hapur rrugën atij më pak “të rrezikshëm”. Për shembull: “Ed” Muskie, i cili gëzonte një mbështetje të gjerë dhe po rritej në sondazhe, u “dogj” në debutimin e tij, kur u shfaq në New Hampshire ku po fillonte procesi i nominimit. Spiunët punësuan rreth njëqind djem të cilët, në mes të natës, i telefonuan demokratëve duke u prezantuar si grupi “Harlem for Muskie” dhe duke kërkuar një votë preferenciale. Ora e vonë e telefonatave i bezdisi bashkëbiseduesit dhe propozimi i një shoqate të zezakëve, që synonte një elektorat të bardhë ende mjaft konservator, rezultoi deçiziv për t'i bindur që të zgjidhnin kandidatë të tjerë.

Internet nuk kishte atëherë dhe ajo që sot do të mohohej lehtësisht me një klikim, më pas u mor si e mirëqenë dhe Muskie mbeti i ulur në dëborë me kokën në duar. Duke krijuar ngatërresa organizative, ata shkatërruan një sërë konventash. Gjë që nga njëra anë ngadalësoi krijimin e një fushate elektorale efektive dhe nga ana tjetër demoralizoi radhët e partisë. Në fund, ata lejuan që kundërshtari të ishte McGovern, një senator nga Dakota e Jugut, i konsideruar “më i largët majtas” kundër të cilit argumentet e Nixonit do të kishin qenë më efektive. Ata gjithashtu e nxorrën nga loja kandidatin për zëvendëspresident, Thomas Eagleton, duke gërmuar disa raporte mjekësore në lidhje me të, që përfshinin seanca elektroskoku për të trajtuar

depressionin. Pra, pas gjashtë apo shtatë përgjigjeve negative, dyshja për t'iu kundërvënë Nixonit u plotësua me Sargent Shriver. E gjithë kjo ka ndodhur para 17 qershorit 1972. Në vetvete, nuk do të ishte e nevojshme të ngulmonim me spiunazh kundër demokratëve. Ishte nga një lloj zelli i tepruar që të pestët kërkuar të zëvendësonin pajisjet përgjuese, sepse të vjetrat nuk funksiononin mirë.


Hëngrën një darkë me aragosta në restorantin e hotelit dhe më pas iu futën një pune, të cilën nuk arritën ta përfundonin. Kutia e Pandorës që u zbulua e ktheu në qendër të vëmendjes një skandal të destinuar të bëhej prototipi i skandalit politik. Por nuk ndodhi menjëherë. Në zgjedhjet presidenciale (7 nëntor 1972) Nixon fitoi 49 nga 50 shtete. Ai i la kundërshtarit vetëm Massachusetts dhe District of Columbia. Për demokratët, një humbje shkatërrimtare. Barku i Amerikës bërtiste për siguri dhe stabilitet. Lufta e Vietnamit e cila u zvarrit me gjakun e ushtarëve amerikanë, trazirat e studentëve në universitete (duke filluar me atë të Berkli), klima e konfliktit me Kinën e Maos kërkonte përgjigje qetësuese, që republikanët dukeshin të aftë për t'i ofruar.

Washington Post nuk lëshoi asnjë milimetër. Gazeta ishte – dhe është – krenarisht demokratike. Drejtori i saj, Ben Bradlee këmbënguli. Gazetarit Woodward i cili kishte qenë oficer në Marinë, por ishte ende mjaft i papjekur në botën e informacionit, iu bashkua Carl Bernstein, i cili kishte një

duzinë vitesh që merrej me gazetarinë investigative. Çdo ditë ata bashkonin copëzën e një enigme që në fund rrethoi Shtëpinë e Bardhë. Të dy përfituan nga ndihma që u erdhi nga një informator sekret, të cilin e quajtën “depthroat. Vetëm rreth tridhjetë vjet më vonë, Mark Felt rrëfeu se ai ishte personazhi misterioz që ofronte informatat.

Një personazh jo krejt i pastër. Ai ishte zëvendësdrejtor i FBI-së dhe, natyrisht, për Watergate-in, ai i dinte të gjitha gjërat. Disa e përkufizojnë si “idealist”, por shumica theksojnë se qëndrimi i tij mund të shpjegohet edhe me zhgënjimin që nuk u promovua në drejtimin e Agjencisë. Kur John Edward Hoover vdiq, ai mendoi se mund të bëhej numri një. Në vend të kësaj, brenda pak muajsh, me dekret të Nixonit, të tjerë e pasuan në krye të FBI-së. Inati ndaj administratës republikane mund ta ketë bindur të takojë Woodward-in në parkingun e nëndheshëm për ta vënë atë në rrugën e duhur dhe, veçanërisht, për ta këshilluar të “ndiqte paratë”. Ndiq paratë. Dhe, në fakt, u identifikuan fonde të destinuar për spiunazh dhe fonde të përdorura (më pas) për të mashtruar hetuesit. Hetimi mbërriti në derën e dhomës Ovale.

Nixoni – kjo duket e sigurt – nuk kishte dijeni për marifetet e komitetit të tij zgjedhor, por – dihet po me kaq me siguri – ai punoi për të mbuluar hetimet dhe për t'i fevjuar ato. Nuk kishte alternativë tjetër veç dorëheqjes. ■ bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Beshiktashi arrin marrëveshje me Muriqin

STAMBOLL, 9 GUSHT - Vedat Muriqi pritet t'i japë lamtumirë aventurës së tij në La Liga me Mallorca dhe të rikthehet të luajë sërish në Turqi pas katër vitesh. Mediumi turk "Aksam" raporton se Muriqi ka vendosur të kthehet në Turqi me fanellën e

Beshiktashit, duke arritur një marrëveshje për kontratë dyvjeçare. Gjithashtu, thuhet se nëse Beshiktashi nuk ka mundësi ta blejë sulmuesin 30-vjeçar prizrenas, ata mund ta marrin atë në huazim. Sulmuesit Jackson Muleka dhe Vincent Aboubakar

do të largohen nga skuadra, kurse klubi turk duan t'i besojnë rotacionin e qendërsulmuesit Ciro Immobiles, Vedat Muriqit dhe talentit të tyre të ri, Mustafa Erhan Hekimoglu. Vlera aktuale e yllit të "Dardanëve" në treg është përcaktuar 12 milionë euro.



## Rikthehet futbolla, sot zhvillohen dy ndeshje

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 GUSHT - Superliga e futbollit të Kosovës rikthehet pas një pushimi për ta filluar edicionin 2024/2025 me dy ndeshje mjaft interesante. Nga ora 17:00 zhvillohet ndeshja në mes të Llapit dhe Gjilanit në stadiumin "Zahi Pajaziti". Këto dy klube me ndryshimet e bëra kanë synime të mëdha në edicionin e ri futbollistik dhe fillimi i mbarë me fitore do të thotë shumë për ecurinë e garave. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Ferizajt dhe Feronikelit, klube këto që kanë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për stinorin që fillon sot. Nesër (e diel) zhvillohen dy ndeshje të tjera. Kampioni në fuqi, Ballkani, e nis rrugëtimin për mbrojtjen e titullit me përballjen ndaj Dukagjinit nga Klina. Skuadra nga Suhareka e ka humbur ndeshjen në rrethin e tretë në Ligën e Konferencës nga Larna, me rezultat 0-1.



Kampionët e Kosovës pësuan gol në minutat e fundit dhe kualifikimi tutje do të jetë mjaft i vështirë për faktin se luan si mysafir. Në anën tjetër,

Dukagjini ka bërë shumë ndryshime, përfshirë edhe shtabin teknik, ku skuadrën tash e drejtonin Ismet Munishi në vend të Armend Dallkut,

dhe në këtë kampionat ka synime edhe më të mëdha sesa në kampionatet e kaluara. Nga ora 19:00 në stadiumin "Fadil Vokrri", Prishtina e pret

Suharekën që luan për herë të parë në Superligë. Kryeqytetasit kanë bërë shumë ndryshime si në radhët e futbollistëve ashtu edhe në shtabin teknik dhe pritet të shihet se si do ta nisin kampionatin. Mjaft interesante do të jetë se si do të luajë ndeshjen e parë në elitë klubi i dytë nga qyteti i Suharekës. Ndeshja e pestë që është paraparë të zhvillohet në mes të Dritës dhe Malishevës është shtyrë. Kjo ka ardhur me kërkesën e klubit gjilanas që është i angazhuar në Ligën e Konferencës. Drita ndeshjen e parë e humbi në Letoni nga Auda (1-0).

### SUPERLIGA - Java e parë

Të shtunën takohen:  
17:00 KF Llapi - SC Gjilani  
17:00 Ferizaj - Feronikeli 74

Të dielën takohen:  
17:00 Ballkani - Dukagjini  
19:00 Prishtina - Suhareka  
Drita - Malisheva (shtyhet)

## Genc e Getoar Bujupi edhe zyrtarisht bëhen gjyqtarë të EHF-së



PRISHTINË, 9 GUSHT - Tashmë është zyrtarë. Genc Bujupi dhe Getoar Bujupin, dy gjyqtarët e Federatës së Hendbollit të Kosovës, do t'i shohim duke drejtuar ndeshje evropiane të klubeve dhe ekipeve kombëtare. Çifti i gjyqtarëve Bujupi tashmë edhe zyrtarisht kanë bexhin e EHF-së dhe vetëm pritet fillimi i edicionit të

ri garues në Evropë për delegimet e para. EHF-ja të premten njoftoi zyrtarisht se 13 çifte gjyqtarësh morën bexhin e "EHF Referee". Kurset e fundit janë mbajtur në Prishtinë dhe në Drammen të Norvegjisë. Genc e Getoar Bujupi kanë qenë në programin e EHF-së, Young Referee Programme, ndërsa në hendbollin e Kosovës

ka shumë vjet që janë prej gjyqtarëve kryesorë. Ata kanë drejtuar me shumë sukses ndeshje të shumta në Evropianin U20 për hendbollistë që u mbajt muajin e kaluar në Prishtinë. Është ky një tjetër sukses i Federatës së Hendbollit të Kosovës që sërish i ka katër çifte gjyqtarësh me thirrje të EHF-së.

## Zyrtarë: Olmo, lojtar i Barcelonës

BARCELONË, 9 GUSHT - Barcelona ka njoftuar zyrtarisht transferimin e yllit spanjoll, Dani Olmo, nga RB Leipzig. Omo luajti për Dinamo Zagrebin e më pas në RB Leipzig. Pas shkëlqimit të klubit gjerman dhe me Spanjën në "Euro 2024", Barcelona vendosi ta transferojë

lojtarin në Camp Nou, duke nënshkruar kontratë gjashtëvjeçare me lojtarin. "FC Barcelona dhe RB Leipzig kanë arritur marrëveshje për transferimin e Dani Olmos. Lojtari do të nënshkruajë një kontratë me klubin për gjashtë

sezonet e ardhshme deri më 30 qershor 2030. Klauzola e tij e blerjes është vendosur në 500 milionë euro", thuhet në njoftimin e katalunasve, të cilëve transferimi i lojtarit thuhet se u ka kushtuar rreth 62 milionë euro, përfshirë bonuset.



## ShBA-ja thyen Serbinë, 'fluturon' në finale

PARIS, 9 GUSHT - ShBA-ja, favoritja absolute për ta fituar medaljen e artë në basketboll për meshkuj, nuk zhgënjëu, edhe pse përballë Serbisë së Jokiçit vuajti jashtëzakonisht shumë, ku u desh një fitore me përmbysje për të siguruar

një vend në finale ku i pret Franca. Ekipi i ëndrrave, i udhëhequr nga një super Stephan Curry, u zgjua vetëm në fund duke rikuperuar 17 pikë. Serbia udhëhoqi thuasj të gjithë ndeshjen, ku dyshja Jokic-Bogdanoviç vendosën

në vështirësi kampionët në fuqi olimpik, me këtë të fundit, Bogdanoviç, që realizoi 20 pikë. Për herë të parë, ShBA-ja kaloi në avantazh dy minuta nga fundi teksa ktheu rezultatin në 87-86, ndërsa më pas

Curry dhe LeBron James bënë diferencën duke mbyllur këtë takim me shifrat 95-91. Curry ishte lojtari i ndeshjes me 36 pikë të realizuara, ndërsa LeBron James e mbylli me 16 pikë, 12 ribounde dhe 10 asistime. Në finale, ShBA-ja



synon medaljen e artë dhe mbrojtjen e titullit kampion.

## Përcaktohet java e parë e kampionatit elitare në Shqipëri

TIRANË, 9 GUSHT - Kampionati i Kategorisë Superiore do të ngrëjë siparin e edicionit të 86 më 18 gusht. Komisioni i Ligave dhe Garave në FSHF ka përcaktuar kalendarin e ndeshjeve të kampionatit "Kategorisë Superiore" për javën e parë që do të luhen të ndara në dy ditë, konkretisht më 18 dhe 19 gusht. Më 18 gusht do të luhen takimet Dinamo City - Egnatia, sfidë që do të luhet në stadiumin "Elbasan Arena" në orën 20:00, teksa në po të njëjtën orë do të luhet në stadiumin "Niko Dovana" edhe ndeshja Teuta - Bylis. Më 19 gusht do të luhen tri përballjet e radhës të javës së parë të kampionatit "Kategoria Superiore". Laçi do ta presë Tiranën në shtëpi, me sfidën që do të luhet në orën 17:00. Dy takimet e radhës do të luhen në ora 20:00, konkretisht Partizani a-Vllaznia, që do të zhvillohet në stadiumin "Arena e Demave" dhe Skënderbeu - Elbasani që do të luhet në Korçë.



### Kategoria Superiore - Java e parë

Dinamo City - Egnatia, 18 gusht, ora 20:00, "Elbasan Arena"  
Teuta - Bylis, 18 gusht, ora 20:00, "Niko Dovana"  
Laçi - Tirana, 19 gusht, ora 17:00, stadiumi i Laçit  
Partizani - Vllaznia, 19 gusht, ora 20:00, "Arena e Demave"  
Skënderbeu - Elbasani, 19 gusht, ora 20:00, stadiumi "Skënderbeu"

## Verstappeni, bisedime sekrete me Mercedesin

SHTUTTGART, 9 GUSHT - Max Verstappeni është duke shijuar pushimet verore të Formulës 1, duke qëndruar në jug të Francës. Gjithsesi, merkato e pilotëve vijon të jetë mjaft interesante si për atë që do të ndodhë sezonin tjetër, po ashtu edhe për vitin 2026, kur hyjnë në fuqi rregullat e reja. Kontrata e pilotit holandez me Red Bullin skadon në vitin 2028, por ajo mund të mbyllet më herët si pasojë e disa klauzolave në favor të pilotit. Shefi i Mercedesit, Toto Wolff, ka kohë që flet për ardhjen e tri herë kampionit të botës, por kjo mund të ndodhë pikërisht në vitin 2026. "F1-Insider" shpjegoi se ka disa klauzola që do ta bënin ta mundur lamtumirën e Max Verstappeni. Në këtë drejtim, një dialog konfidencial është duke u zhvilluar midis Max e babait të tij Jos Verstappen, Toto Wolff dhe Ola Kalleniuss. "Nëse kurba e performancës së Red Bullit



vazhdon të bjerë dhe kurba e performancës së Mercedesit vazhdon të rritet, vendimi për të shkuar te Mercedesi, tashmë është marrë. Duke iu referuar vitit 2026 dhe jo atij të ardhshëm", shkuar "F1

Insider". Plani i Mercedesit do të ishte ky: Zyrtarizmi i çiftit Antonelli - Russell për 2025 në garën e Monzas dhe më pas do të garantojnë një vend për Verstappenin për vitin 2026.

## Owen: Liverpoolit i duhet Gordoni

Michael Owen i ka kërkuar Liverpoolit të nënshkruajë me Anthony Gordon nga Newcastle nëse është e mundur. Ai pretendon se trajneri i Magpies, Eddie Howe, do të bëjë gjithçka

për ta mbajtur lojtarin pasi ai është një nga të rinjtë më emocionues në kampionat. Duke folur për Casino Hawks, Owen pohoi se Gordon është lloji i lojtarit që Liverpooli duhet

të marrë. "Nuk ka dyshim që Anthony Gordon është një djalë i talentuar. Nëse Newcastle nuk ka probleme me paratë, atëherë nuk mund ta imagjinoj se do të duan të largojnë një nga lojtarët

e tyre të rinj më emocionues", ka thënë ai. "Ai ka bërë shumë mirë të Newcastle që kur ka qenë atje, kështu që jam i sigurt se Eddie Howe është i dëshpëruar për ta mbajtur atë.

Nëse një lojtar si Gordon është në dispozicion, atëherë sigurisht që ky është lloji i lojtarit për të cilin Liverpooli duhet të interesohet", ka deklaruar Owen.

### SHKURT

#### Pensionohet Pepe

Mbrojtësi portugez Pepe ka njoftuar për tërheqjen e tij nga futbollit, duke i dhënë fund një prej karrierave më të dekoruara kohën e fundit. Pepe, 41-vjeçar, u bë lojtari më i vjetër që u paraqit në një finale të Kampionatit Evropian këtë verë, dhe ndeshja e tij e fundit ishte humbja e Portugalisë me penallti nga Franca në çerekfinale. Ish-qendërmbrojtësi i Real Madridit bëri 141 paraqitje për vendin e tij, ndërsa ai gjithashtu luajti për Porton, Beshiktash dhe Maritimo. Pepe falënderoi ata që e kanë ndihmuar gjatë karrierës së tij në një video 33-minutëshe, plot me emocione, të postuar në internet të enjten.

#### Richarlison refuzon kalimin në Arabinë Saudite

Sulmuesi Richarlison dëshiron të qëndrojë te Tottenham Hotspuri pasi ka refuzuar një transferim në Arabinë Saudite. Sulmuesi brazilian 27 vjeç iu bashkua Spursit nga Evertoni në vitin 2022 për një shumë rekord të klubit prej 60 milionë paundësh. Ai ka shënuar 15 gola në 66 paraqitje për Tottenhamin dhe nuk ka qenë gjithmonë titullar sezonin e kaluar nën drejtimin e trajnerit Ange Postecoglou. Richarlison, kontrata e të cilit zgjat deri në vitin 2027, ka tërhequr interesin e një numri klubesh në Arabinë Saudite, me një ekip të paidentifikuar që ka bërë një ofertë. Megjithatë, ai thotë se dëshiron të qëndrojë në Angli për t'i përmirësuar shanset e tij për ta vazhduar karrierën ndërkombëtare me Brazilin.

#### Atleti nga Pakistani e thyen rekordin olimpik

Arshad Nadeem nga Pakistani ka thyer rekordin olimpik në hedhjen e shtizës me një gjuajtje të jashtëzakonshme prej 92.97 metrash, duke siguruar fitoren në Stade de France. Kjo përpjekje monumentale e bëri atë medalistin e parë të vendit të tij pas 32 vitesh dhe të parin që ka fituar një medalje të artë në atletikë, në një natë historike për Pakistanin. Norvegjezi Andreas Thorkildsen kishte mbajtur rekordin e hedhjes së shtizës që nga Lojërat Olimpikë të vitit 2008, por distanca e tij prej 90.57 metrash u tejkalua dukshëm me më shumë se dy metra në dritat e Parisit mbremë. Pasi shtiza e 27-vjeçarit preku tokën përpara kufirit që tregonte rekordin olimpik, medalja e artë ishte praktikisht e garantuar, ndërsa ai i la rivalët e tij pas në garë. Fituesi i medaljes së argjendtë, Neeraj Chopra, mbeti tri metra e gjysmë pas rivalit të tij pakistanez, pasi indiani arriti të hedhë një distancë prej vetëm 89.45 metrash.

#### ShBA-ja vazhdon të kryesojë me numrin e medaljeve të fituara në Lojërat Olimpikë

ShBA-ja vazhdon të kryesojë me numrin e medaljeve të fituara në Lojërat Olimpikë. Në fund të ditës së 13-të të Lojërave Olimpikë "Paris 2024", ShBA-ja po kryeson tabelën në mesin e vendeve të tjera me gjithsej 103 medalje të fituara, prej të cilëve 30 medalje të arta, 38 të argjendta dhe 35 të bronzta. ShBA-ja vazhdon të qëndrojë në krye të tabelës në ditën e 13-të të Lojërave Olimpikë, pasi fitoi 3 medalje të arta, 3 të argjendta dhe 3 të bronzta. Kina, e cila e përfundoi ditën me 4 medalje të arta, 2 të argjendta dhe 3 të bronzta, u rendit e dyta me 73 medalje në total. Australia u rendit e treta, kurse Franca, e cila i mirëpriti këto lojëra, është në vendin e katërt.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Trinity Logistics” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811919151 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Trinity Logistics” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811919151 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Trinity Logistics” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811919151 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kosherja” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811316878 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kosherja” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811316878 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Kosherja” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811316878 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Enisi Trade” SH.P.K. me seli në Viti, pronar Faruk Sylejmani dhe Violeta Rizahi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70896060 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Enisi Trade” D.O.O. Viti, Faruk Sylejmani dhe Violeta Rizahi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70896060 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Enisi Trade” L.L.C. Viti, Faruk Sylejmani dhe Violeta Rizahi, has come to the decision to quit its business: 70896060 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Fidajete Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl VI - IX shfmu “Dëshmorët e Kabashit “ Korishe
- Jetmire Bajrami shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren
- Bleorant Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**MEKA**  
HALAL FOOD

**TRADITË QË NGA**

**1992**







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

